



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2016
Nr. Dok. 201600634/3

Lënda : *Rekomandim për marrjen e masave tekniko - organizative dhe ligjore me qëllim krijimin e standardeve të reja të gjykimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.*

Drejtuar : **Z. Ylli MANJANI**
Ministër i Drejtësisë

TIRANË

Për dijëni : **SH.T. Z.Bujar NISHANI**
President i Republikës së Shqipërisë,
dhe Kryetar i KLD-së.

SH.T.Z. Ilir META
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

SH.T.Z. Edi RAMA
Kryeministër i Republikës së Shqipërisë

Z. Fatmir XHAFA
Kryetar i Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore,
Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

TIRANË

I nderuar zoti Manjani,

Gjatë dy viteve të fundit në Institucionin e Avokatit të Popullit janë administruar disa ankesa të shtetasve të dryshëm, të cilët kanë ngritur shqetësimin në lidhje me zvarritjen e gjykimit të çështjeve të tyre nga Gjykata e Administrative e Apelit Tiranë.

Nga shqyrtimi i këtyre ankesave dhe verifikimet e bërë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë kemi arritur në konkluzionin se, pretendimet e ankuesve për zvarritje të gjykimit të çështjeve të tyre në këtë gjykatë, të cilat shkojnë mbi dy vjet, janë të bazuara.

Ne konstatojmë se vonesa dhe zvarritja e gjykimit të çështjeve nga kjo gjykatë përbën shkelje të të drejtës së shtetasve për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor të garantuar nga aktet normative të mwposhtme:

1. Kushtetuta jonë, respektivisht neni 42/2 ku parashikohet se: *“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.*

2. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, respektivisht neni 6/1, ku parashikohet se: *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj....”.*

3. Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, respektivisht neni 48/2 ku parashikohet se: *“Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi”.* Sikurse rezulton nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore, çështjet gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë duhet të përfundojnë së gjykuari brenda 30 ditëve, afat ky që fillon nga data e dërgimit të dosjes në këtë gjykatë nga gjykata ku është bërë ankimi.

Vonesa në gjykimin e çështjeve në këtë gjykatë është kthyer tashmë në fenomen. Ajo, përveç se përbën një shkelje procedurale dhe cënim të të drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe brenda një afati të arsyeshëm të garantuar nga aktet normative të citura më sipër, vjen në kundërshtim edhe me qëllimin e ligjvënësit për miratimin e Ligjit nr. 49/2012, i cili është shpejtimi i gjykimit të çështjeve administrative dhe jo zvarritja e gjykimit të tyre. Në nenin 3 të Ligjit nr. 49/2012, një ndër parimet e gjykimit administrativ është parashikuar edhe sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ligji vet synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative me qëllim garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave të subjekteve dhe të interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të arsyeshme, por të përcaktuar nga vetë ligji.

Sjellim në vëmendje se, shkelja e të drejtës së shtetasve për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, është konstatuar edhe nga Gjykata Kushtetuese gjatë gjykimit të disa çështjeve me këtë objekt. Referuar jurisprudencës së kësaj gjykate dhe konkretisht vendimeve të saj nr. 69/2015, nr. 81/2015 dhe nr. 14/2016 ajo ka theksuar në mënyrë të qartë dhe të prerë se, përfundimi i gjykimeve në Gjykatën e Administrative të Apelit Tiranë duhet të bëhet brenda afatit 30 ditor. Gjithashtu ajo ka deklaruar se

mosgjykimi i çështjeve brenda këtij afati ligjor përbën shkelje të parimit kushtetues të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor.

Ndërkohë kemi konstatuar se, vonesa dhe zvarritja e gjykimit të çështjeve të ankuesve, por edhe të çështjeve të shumë shtetasve të tjerë nga Gjykata e Administrative e Apelit Tiranë ka ndodhur për shkaqe objektive të cilat lidhen me numrin e madh të çështjeve të ardhura në këtë gjykatë. Numri i madh i çështjeve në këtë gjykatë u krijua edhe për shkak të Vendimeve Unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, respektivisht nr. 3, datë 06.12.2013; nr.4, datë 10.12.2013 dhe nr. 3, datë 28.04.2014, nëpërmjet të cilave u vendos që qindra çështje që ishin në pritje për gjykim në Gjykatat e Apelit në shkallë vendi, të gjykohen nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë. Me dekretin nr. 8349 datë 14.10.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë u vendos data 04.11.2013 për fillimin e funksionimit të Gjykatave Administrative. Kjo datë shënon edhe fillimin e efekteve të plota juridike në zbatim të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, lidhur me gjykimin e çështjeve gjyqësore që kanë për objekt mosmarrëveshjet administrative.

Në fillim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë u caktuan vetëm 7 gjyqtar, dhe për shkak të volumit të madh të çështjeve të ardhura në këtë gjykatë, nga KLD-ja janë komanduar gjyqtar të tjerë nga Gjykata e Apelit Tiranë. Meqënëse numri i çështjeve është i madh dhe numri i gjyqtarëve i vogël dhe për të bërë të mundur përballimin e situatës së krijuar, kohët e fundit organika e kësaj gjykate u shtua edhe me 6 gjyqtar të tjerë.

Nga të dhënat statistikore të marra në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë rezulton se, në vitin 2014 u gjykuan rreth 4000 çështje, në vitin 2015 u gjykuan rreth 3018 çështje dhe aktualisht janë në pritje për gjykim rreth 12000 çështje. Theksojmë se nuk ka mbaruar ende gjykimi i çështjeve të regjistruara në këtë gjykatë gjatë vitit 2014. Ndërsa për fillimin e gjykimit të çështjeve të ardhura në vitin 2015 është parashikuar muaji Tetor 2016.

Nga një studimi paraprak rezulton se, një gjyqtar i kësaj gjykate ka gjykuar rreth 260 çështje gjyqësore në muaj, e cila është një ngarkesë tepër e madhe. Për shkak të kësaj ngarkese është e pamundur që të zbatohet afati ligjor i gjykimit të çështjeve dhe të ruhet cilësia e lartë e gjykimit të tyre dhe e arsytimit të vendimeve gjyqësore.

Ne konstatojmë se, në gjëndjen faktike në të cilën ndodhet kjo gjykatë si përsa i përket numrit të lartë të çështjeve që ndodhen për gjykim dhe numrit të gjyqtarëve aktualë, ajo është në pamundësi që të zbatojnë dhe të respektojnë afatin ligjor 30 ditor për gjykimin e tyre.

Gjithashtu konstatojmë se, përveç shkaqeve të përmendura më sipër, vonesa në gjykim vjen edhe për shkak të praktikës që zbatohet nga kjo gjykatë për arsytimin e vendimeve edhe në rastet kur ajo le në fuqi vendimet e Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë, për të cilat shpenzohet shumë kohë.

Nga informacionet që kemi rezulton se, ka eksperiencë ndërkombëtare, si në SHBA dhe Gjermani që në rastet kur Gjykatat (Administrative) të Apelit lenë në fuqi vendimet e Gjykatave (Administrative) të Shkallës së Parë, nuk bëjnë arsytimin e vendimeve të tyre kur kjo nuk kërkohet nga palët ankuese.

Ne gjykojmë se, për të mundur përmirësimin e punës së Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, dhe për krijimin e standardeve të reja të gjykimit, me qëllim respektimin e të drejtës kushtetuese e ligjore të shtetasve për

zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor (gjyqësor) nëpërmjet gjykimin e çështjeve brenda afatit ligjor, duhen marrë disa masa tekniko - organizative dhe ligjore.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, nga administrata publike”* dhe nenin 21/b të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të nevojshme për shtimin e organikës së Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, edhe me 5 gjyqtarë të tjerë.
2. Përgatitjen dhe bërjen e propozimeve konkrete institucioneve kompetente për ndryshimin e Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” me qëllim që, në rastet kur Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, le në fuqi si të bazuara në ligj dhe në prova vendimet e Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë dhe kur arsyetimi i vendimeve nuk kërkohet nga palët ankuese, të mos bëjnë arsyetimin e vendimeve të tyre.

Për qëndrimin e mbajtur ndaj këtij rekomandimi dhe masat e marra në zbatim të tij, lutemi të njoftohemi brenda afatit 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjin nr. 8545, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimi dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI
Me urdhër dhe porosi të tij

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI